



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:088230

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514661

CN.nr.1968/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtarja individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike të propozuesit-të paditurës Komuna e Shtërpçës, të cilën me autorizim e përfaqëson D.V, avokat nga Shtërpca, kundër paditësit J.D nga fshati G....., Komuna e Sh....., duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga i autorizuari i të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpçë, C.nr.109/2021 e datës 27.09.2021, jashtë seancës me datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pathemeltë propozimi për përsëritjen e procedurës i ushtruar nga i autorizuari i të paditurës Komuna e Shtërpçes, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Shtërpçë, C.nr.109/2021 e datës 27.09.2021.

A r s y e t i m

E paditura përmes të autorizuarit të saj, me datën 11.11.2021, ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpçë C.nr.109/2021 e datës 27.09.2021, me të cilin është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të cilin propozim e ka bazuar në nenin 232 pika g) e LPK-së, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovon propozimin dhe të lejon përsëritjen e procedurës, si dhe të abrogoj aktgjykimin e lartcekur.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës, në harmoni me dispozitat e nenit 239 paragrafi I e lidhur me nenin 235 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve të paraqitura në propozim, gjeti se:

-Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pathemeltë.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë me aktgjykimin C.nr.109/2021 e datës 27.09.2021, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe e ka detyruar të paditurën që të paguaj shumën përgjithshme prej 1,306 € në emër të shujtave për periudhën kohore prej datës 26.04.2018 e deri me datën 01.04.2021, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e paraqitjes së padis 26.04.2021 e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit dhe atë për shumën 40 € për shkak të parashkrimit të kërkesës. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur për shpenzimet e procedurës në shumë prej 30.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi ndërgjyqësit nuk kanë paraqitur ankesë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, në raport me pretendimet e të paditurës për përsëritjen e procedurës, erdh në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara sipas nenit 232 pika g) e LPK-së, që të lejohet përsëritja e procedurës në këtë çështje juridike, për këto arsye si vijon: Sipas kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi ka paraparë se, në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, e që sikur t'i dinte këto fakte ose t'i kishte parashtruar këto prova në procedurë të mëparshme, do të nxjerrët një vendim më të favorshëm. Kusht është që këto fakte të kenë ekzistuar para përfundimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, po që se këto fakte nuk kanë qenë të ditura për palët. Në rastin konkret provën të cilën e ka bashkangjitur e paditura në propozimin për përsëritjen e procedurës, nuk paraqet provë të re, ngase këto pretendime kanë të bëjnë me zbatim të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale, e për të cilin aktgjykim rezulton se e paditura nuk e ka shfrytëzuar të drejtën në mjetin juridik kundër aktgjykimit të lartcekur, ku Gjykata e Apelit do të kishte mundësi që të kujdeset sipas detyrës zyrtare edhe për zbatimin e të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CN.nr.1968/2022, dt.27.03.2024

Gjyqtarja individuale

Nora Bllaca-Dula, d.v

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së dorëzimit, trupit gjykues të Gjykatës së Apelit sipas neni 240.4 të LPK-së.